



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 30 gusht 2012
Nr. ref.: RK 290/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI158/11

Parashtruesi

Gjykata Komunale në Ferizaj-Dega në Shtërpçë

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës
Kushtetuese të Serbisë, Tu. Nr 367/90, të datës 21.03.1991**

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Cukalovic, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare.

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Gjykata Komunale në Ferizaj-dega në Shtërpçë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar i autoritetit publik, vlerësimi i kushtetutshmërisë i të cilit kërkohet nga Gjykata Kushtetuese, është Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Serbisë, Tu. Nr. 367/90, i datës 21.03.1991.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së referuar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, më 7 dhjetor 2011, është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Serbisë, Tu. Nr. 367/90, i datës 21.03.1991, me anë të cilit është shpallur jokushtetues Vendimi i Kuvendit Komunal të Ferizajt për aprovimin e Planit Detal Urbanistik të Vikend-Zonës në Sharr (i 24 janarit 1979), e i shpallur në Gazetën Zyrtare të KSAK nr. 6, të datës 23 shkurt 1979.

Baza juridike

4. Neni 113.8 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), neni 51 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i datës 16 dhjetor 2009, i hyrë në fuqi më 15 janar 2010 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), dhe neni 29 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 7 dhjetor 2011, Gjykata Kushtetuese pranoi kërkesën e parashtruar nga Gjykata Komunale në Ferizaj –dega në Shtërpçë, në emër të së cilës e kishte nënshkruar gjyqtari Musa Konxheli e me të cilën kërkohet vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar të përshkruar sikur në paragrafin 2 të këtij aktvendimi.
6. Më 30 janar, Gjykata Kushtetuese i dërgoi një njoftim Gjykatës Komunale në Ferizaj –dega në Shtërpçë se kërkesa e tyre është regjistruar në Gjykatën Kushtetuese me nr. KI-158/11..
7. Më 17 janar 2012, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Gjr. KI 158/11, caktoi Zëvendëskryetarin e Gjykatës, z. Kadri Kryeziu, për ta përpiluar raportin paraprak lidhur me kërkesën. Dhe të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin KSH-KI 158/11, caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje: Altay Suroy (kryesues) dhe gjyqtarët Robert Carolan e Prof. dr. Enver Hasani, anëtarë të kolegjit.
8. Më 19 prill 2012 në seancën për shqyrtimin e kësaj kërkesë, kolegji shqyrtues njëzëri i propozoj gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

9. Më 24 janar 1979, Kuvendi i Komunës së Ferizajt kishte nxjerrë Vendimin 01 nr. 03-1645 për aprovimin e Planit Detal Urbanistik të Vikend-Zonës Sharr dhe ky vendim ka hyrë në fuqi pas publikimit në Gazetën Zyrtare të ish-Krahinës së Kosovës (shih gazeta nr. 6 e datës 23 shkurt 1979, faqe 176).

10. Plani detal urbanistik ka përfshirë prona të paluajtshme në komunën kadastrale Vërbishticë dhe komunën kadastrale Shtërpçë, të renditura në parcelat kadastrale në nenin 1 të vendimit të sipërpërmendur.
11. Pronat e paluajtshme, të specifikuar në vendimin e datës 24 janar të vitit 1979 të Komunës së Ferizajt për qëllimin e zbatimit të atij vendimi, janë eksproprijuar sipas legjislacionit në fuqi të asaj kohe.
12. Në vitin 1988 (data e palexueshme) Gjykata Kushtetuese e Kosovës (KSAK) ka nxjerrë Vendimin U. 77/88 1988, me të cilin kishte refuzuar kërkesën e Bashkësisë Lokale të Shtërpçës për të shpallur të papajtueshëm me Kushtetutën vendimin e Kuvendit të Komunës së Ferizajt lidhur me planin detal Urbanistik të Vikend-Zonës SHARR, dhe rrjedhimisht me këtë, edhe të eksproprijimit të pronave të paluajtshme që përfshihen në këtë plan urbanistik (ky fakt konstatohet nga kopja e Vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Serbisë, Tu. Nr. 367/90, të datës 21.03.1991).
13. Më 13 maj 2011, znj. Milica Petkovic nëpërmes përfaqësuesit të saj të autorizuar, avokatit z. Sadri Godanci, kishte paraqitur padi për vërtetimin e pronësisë në Gjykatën komunale në Ferizaj-dega në Shtërpçë, nga e cila kërkonte që ky institucion të vërtetojë të drejtën e pronësisë mbi parcelat në sipërfaqe prej 1444 m², përkatësisht 725², e të cilat ishin eksproprijuar me vendimin e Kuvendit Komunal në Ferizaj të vitit 1979. Kjo lëndë ishte regjistruar në këtë Gjykatë me numër C. nr. 17/11.
14. Përfaqësuesi i paditëses si provë që mbështet kërkesën e klientit të tij kishte paraqitur edhe Vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Serbisë, Tu. Nr. 367/90, të datës 21.03.1991, e i cili kishte shpallë jokushtetues vendimin e KK të Ferizajt për Vikend-Zonën "Sharr".
15. Më 10 tetor 2011, gjatë seancës gjyqësore pala e paditur, Komuna e Ferizajt, kishte kontestuar këtë provë dhe mes tjerash kishte propozuar që të ndërpritet procesi dhe që Gjykata Kushtetuese e Kosovës të deklarohet lidhur me kushtetutshmërinë e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Serbisë.
16. Më 30 nëntor gjyqtari i çështjes, z. Musa Konxheli, kishte nxjerrë aktvendim me të cilin miratohet propozimi i palës së paditur dhe e kishte referuar çështjen në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës nga e cila kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar të GJ. Kushtetuese të Serbisë.
17. Më 7 dhjetor 2011, në Gjykatë Kushtetuese ka arritur kërkesa formale lidhur me këtë çështje.

Shkeljet e pretenduara drejtave të garantuara kushtetuese

18. Parashtruesi i kërkesës nuk ka specifikuar se cilat shkelje kushtetuese mund të jenë bërë me vendimin e kontestuar, por ka kërkuar vlerësimin e pajtueshmërisë së tij me Kushtetutën në përgjithësi.
19. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu ka kërkuar që Gjykata Kushtetuese e Kosovës të jap interpretim meritore nëse vendimi i kontestuar është nxjerrë nga një organ i autorizuar duke marrë parasysh kohën dhe vendin e nxjerrjes (viti 1991 pas suprimimit të Autonomisë së Kosovës, në Beograd), nëse vendimi është diskriminues dhe nëse Gjykata Komunale e Ferizajt –dega në Shtërpçë duhet ta marrë parasysh si fakt relevant këtë vendim gjatë shqyrtimit të lëndëve –pasive për vërtetimin e pronësisë, pasi që ky fakt është kontestuar nga njëra palë në procedurë dhe Gjykata Komunale e

Ferizajt-dega në Shtërpcë e ka ndërprerë deri në vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

20. Për të qenë në gjendje të gjykojë për kërkesën e parashtruesit të saj, Gjykata duhet paraprakisht të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë të cilat përcaktohen në Kushtetutë, Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e punës së Gjykatës.
21. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.8 të Kushtetutës që përcakton se:

“Gjykatat kanë të drejtë t’i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji, nëse ajo përputhshmëri është ngritur gjatë procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese nuk është e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën dhe nëse vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar, varet nga përputhshmëria e ligjit në fjalë.”,

dhe

Nenit 51 par. 1 e 2 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, ku shprehimisht përcaktohet se:

1. Kërkesa e ngritura në pajtim me nenin 113, paragrafi 8 të Kushtetutës do të parashtrohet nga gjykata vetëm nëse ligji i kontestuar duhet të zbatohet drejtpërsëdrejti në çështjen që është pjesë e lëndës në shqyrtim dhe vetëm nëse ligjshmëria e ligjit të kontestuar është parakusht për marrjen e vendimit nga ana e gjykatës.

2. Kërkesa do të specifikojë cilat dispozita të ligjit konsiderohen në kundërshtim me Kushtetutën.

Gjykata gjithashtu merr parasysh:

Rregullin 36 par. 3 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese, ku përcaktohet:

“ (3) Po ashtu një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese kur:

f) kërkesa nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.

22. Duke iu referuar kërkesës së Gjykatës Komunale në Ferizaj lidhur me çështjen e shtruar për shqyrtim, Gjykata konstaton:

Sa i përket çështjes kushtetuese dhe palës së autorizuar:

23. Sikur u theksua në paragrafin 21 të këtij aktvendimi, gjykatat janë palë të autorizuar të ngritin çështje kushtetuese brenda kornizave të parapara me nenin 113.8 të Kushtetutës dhe nenit 51 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, dhe çështja për të cilën i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese duhet gjithmonë të jetë e mbuluar me dispozita kushtetuese sa i përket materies kushtetuese (shih mutatis mutandis X vs Germany, Aplikacioni nr ° 7462/76 **Vendimi për Papranueshmëri – *ratione materiae* 7 mars 1977).**

24. Në fakt, përkufizimi kushtetues dhe ai ligjor lidhur me kompetencat e gjykatave për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese përcakton qartë se ato janë të autorizuar të kërkojnë vlerësimin e përputhshmërisë së LIGJEVE me Kushtetutën dhe jo edhe të ndonjë akti tjetër juridik (kontrolli incidental i kushtetutshmërisë).
25. Nga kërkesa e parashtruar nga Gjykata Komunale e Ferizajt-dega në Shtërpcë, padyshim konstatohet se kjo gjykatë nuk kishte kërkuar vlerësimin e përputhshmërisë së ndonjë ligji me Kushtetutën por të një vendimi të Gjykatës, e që nuk përkon me kompetencën kushtetuese të gjykatave sipas nenit 113.8 për të ngritur çështje në Gjykatën Kushtetuese.
26. Gjykata Kushtetuese thekson se edhe pse çështja e ngritur nga Gjykata Komunale ka lidhshmëri të drejtpërdrejtë me procesin gjyqësor që shqyrtohet nga ajo, prapë se prapë çështja themelore e ngritur është RATIONE MATERIE e pajtueshme me Kushtetutën sepse nuk është akt juridik për të cilin mund të kërkohet vlerësimi i kushtetutshmërisë nga gjykatat.

Sa i përket çështjeve për të cilat kërkohet vlerësimi kushtetues:

27. Gjykata Kushtetuese thekson se për sa i përket çështjeve substanciale të ngritura në kërkesë, ajo nuk është gjykatë e verifikimit të fakteve dhe nuk mund të paragjykojë se cilat fakte do të merren në konsideratë nga gjykatat e rregullta gjatë shqyrtimit të rasteve që ato i kanë në shqyrtim.
28. Konstatimi i gjendjes faktike, të drejtë dhe të plotë, është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta dhe se roli i sajë (i GJ. Kushtetuese) është vetëm që ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore, prandaj nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkalës së katërt" (shih, *mutatis mutandis*, i.a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65)
29. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese vëren se në Vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Serbisë, Tu. Nr. 367/90, të datës 21.03.1991, është theksuar fakti se Gjykata Kushtetuese e Kosovës në vitin 1988, me Vendimin U nr. 77/88, është deklaruar si gjykatë kompetente kushtetuese në atë kohë dhe ky fakt do të duhej të merrej parasysh edhe nga gjykatat e rregullta.
30. Në këto rrethana, parashtruesi i ankesës nuk ka ngritur një çështje kushtetuese brenda kompetencave të parapara me nenin 113.8, andaj në përputhje me nenin 36 par. 3 (f) kërkesa duhet të vendoset si e papranueshme për shkak të papajtueshmërisë "ratione materiae" me Kushtetutën.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.8 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese në seancën e 19 prillit 2012, njëzëri:

VENDOSI


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Mr.Sc. Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani